



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:165999

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05842081

KP.nr. 31/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit D.V.D ING Sh.p.k me seli në Vushtri, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Zenel Shala me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Kuvendi Komunal Vushtrri, me objekt kontesti Përmbushja e kontratës, mënjanimi i pengesave për hyrje në posedim dhe kompensim i dëmit, vlera e kontestit 64,875.00 Euro, jashtë seance, më datën 20.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në çështje kontestimore me numër KP.nr.31/24, në mes të paditësit D.V.D ING Sh.p.k kundër të paditurit Kuvendi Komunal Vushtrri, me objekt kontesti Përmbushja e kontratës, mënjanimi i pengesave për hyrje në posedim dhe kompensim i dëmit.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij Aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj t'i dorëzohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë Dega në Vushtrri - Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi D.V.D ING Sh.p.k përmes të autorizuarit, me datën 10.05.2024, pranë kësaj Gjykate ka ushtuar padi, ndaj të paditurit Kuvendi Komunal Vushtrri, Përmbushja e kontratës, mënjanimi i pengesave për hyrje në posedim dhe kompensim i dëmit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, vlerësoj se Departamenti i Përgjithshëm pranë Gjykatës Komerciale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata erdhi në përfundim se nuk është e kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje, mbështetur në nenin 13, par 1. lidhur me par. 1.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) i cili përcakton: *“1.Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë”*: në vazhdim par. 1.7 *”kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare”*.

Mbështetur në dispozitat e lartcekura, Departamenti i Përgjithshëm pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve në mes të shoqërive tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëri Tregtare dhe Ligjin për Pronësi dhe të Drejta Tjera Sendore.

Në këtë çështje juridike, palë e paditur nuk është shoqëri tregtare e përcaktuar në Ligjin për Shoqëri Tregtare, por person juridik publik, prandaj bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), si dhe bazuar në nenin 41 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006), i cili përcakton *“Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetente gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria.”*. Meqenëse objekt kontesti është edhe pengimi për hyrje në posedim, e sipas kësaj dispozite është e rregulluar kompetenca territoriale ekskluzive, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri – Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata bëri shqyrtimin e kompetencës lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 17 dhe 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj, bazuar në nenet 17 dhe 19 të LPK-së lidhur me nenin 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, nenit 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykatat, dhe konform nenit 392 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.31/24, datë 20.06.2024

Gjyqtari

Gent Bkeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.